



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL

RAPORTI I MONITORIMIT TE ZBATIMIT TE BUXHETIT PËR VITIN 2023.

Përmbajtja e Raportit

- 1. Hyrje, profili i bashkisë, sfidat.**
- 2. Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit të buxhetit për vitin 2023.**
- 3. Raporti i shpenzimeve sipas programeve.**
- 4. Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetore.**
- 5. Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produktet e programit.**
- 6. Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.**
- 7. Raporti i realizimit të investimeve me financim të brëndshëm.**
- 8. Raporti i realizimit të të ardhurave**
- 9. Relacionet spjeguese**

v.o: Ky raport u miratua me Vendimin e Keshillit te Bashkise nr. , datë 29.02.2024.

HYRJE.

Profili i bashkisë

Bashkia Dropull, është pjesë e Qarkut Gjirokastr dhe kufizohet në veri me bashkinë Libohovë, jug dhe juglindje me Republikën Helene, perëndim me bashkinë Finiq.

Kjo bashki përbëhet nga tre njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm me qendër fshatin Sofratikë, Dropull i Sipërm me qendër fshatin Vrisera dhe Pogon me qendër fshatin Polican. Të tri njësitë administrative kanë nën administrimin e tyre 41 fshatra.

Qendra e Bashkisë është fshati Jorgucat.

Sipas regjistrimit të gjendjes civile, me datë 01.01.2023, numëron 22.186 banorë, i ndarë sipas njësive administrative: Dropulli i Sipërm 10038 banorë, Dropull i Poshtëm 9132 banorë dhe Pogon 2966 banorë.

Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 47.54 banorë/km².

Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të komunitetit etnik grek në Shqipëri.

Bashkia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar ndër shekuj fillokseninë (mikpritjen), gjuhën, artin dhe qytetërimin helen, vallet e bukura, polifoninë, kostumet e pasura, motivet epirote të klarinetës, kishat dhe manastiret, sitet arkeologjike, arkitektoninë karakteristike, punimet e gurit, artizanatin, zejet, përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, gastronominë, etj.

Sipas regjistrimit statistikor të INSTAT (viti 2022), realizojnë aktivitetin e tyre në teritorin e Bashkisë Dropull 306 Ndermarrje, ku ato me status person juridik, zenë 12.8% të numrit total në rang Qarku, me status person fizik 6.1% dhe fermeret 4.9%.

Funksionojnë 4 (kater) kopshte publike fëmijësh dhe 2(dy) shkolla të mesme të bashkuara (publike), ku gjatë vitit shkollor 2023-2024, janë frekuentuar nga 36 femije në kopshte, 130 nxënës në arsimin 9-vjeçar dhe 63 nxënës në arsimin e mesëm.

Sipërfaqja e tokës së punueshme (bujqësore) është 8308.7 ha, prej së cilës kultivohet 2917 ha. Egzistojnë 231 ferma blegtorale dhe bujqësore, në të cilat mbarështohen 1000 gjedhë, 14000 te imta, 26000 shpendë dhe 3000 koshere blete. Administron 19 rezervuarë ujëmbajtës për vaditjen e kulturave bujqësore me kapacitet inventarizues 4441 ha, prej të cilave ujiten vetëm 428 ha. Është plotësuar me rrjet kanalesh kullues një sipërfaqe prej 5934 ha.

Bashkia Dropull administron një sipërfaqe kullimore prej 11508 ha, me kapacitet mbajtës, e ndarë në kullota verore për 16338 krerë te imta dhe kullota dimërore 7894 krere. Po kështu disponon dhe administron një sipërfaqe pyjore prej 10.099 ha, që krahas të tjerave disponohet edhe për kullotë pyjore për 18.500 krerë. Për plotësimin me ujë të pijshëm të nevojave të blegtorisë janë në inventar 20 ujëmbledhës të vegjël malorë.

Sfidat me të cilat përballet pushteti vendor:

Sfida baze e organeve të Bashkisë (Keshillit Bashkiak dhe Kryetarit), vazhdon të mbetet sigurimi i furnizimit me ujë pa ndërprerje për 95% të popullsisë, nëpërmjet realizimit të investimeve të parashikuara dhe rritjes së efektivitetit të tyre.

Sfida të tjera në kuadrin e projektplanit të përgjithshëm vendor:

Rritja e aksesueshmërisë dhe integrimi territorial, si në nivel makro dhe atë mikro, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së veprave infrastrukturore të artit, si urat , rrugët ,përmirësimi i menaxhimit të reziqeve natyrore nëpërmjet shtimit të pyllëzimit, mbrojtjes së argjinaturave të lumenjve, sistemimin e pritave dhe përenjve etj.

Integrimi në rajonin ekonomik ndërkufitar përmes zhvillimit dhe diversifikimit të ekonomisë lokale, pjesëmarrjes në projekte evropiane ndërkufitare, afrimit dhe ndërtimit të aktiviteteve të përbashkëta, në interes të komunitetit dhe zhvillimit të turizmit.

Ruajtja e karakterit rural të vendbanimeve, promovimi i traditës, ruajtja e ekosistemit, mjedisit me synim përmirësimin e cilësisë dhe kushteve të jetesës të komunitetit.

Mbrojtja e territorit, e peisazhit dhe habitateve natyrore, si dhe rehabilitimi i veprave infrastrukturore , hartimi i planeve të menaxhimit të burimeve ujore në vaditjen e kulturave bujqësore për përballimin e thatësirës gjatë periudhës së verës.

Krijimin e kushteve për nxitjen e kthimit dhe riintegrimin e emigrantëve, duke rritur sasinë dhe cilësinë e shërbimeve, krijimin e një mjedisi social miqësor, përkrahjen e inisiativave të aktorëve shoqërorë për këtë qëllim, etj

Garantimin e sigurisë publike, rruajtjen nga vjedhjet dhe dëmtimet të pronës private e publike, mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, duke krijuar një klimë tejet miqësore për biznesin, emigrantët dhe turizmin, sidomos kjo në zonat e thella në njësitë administrative Dropull i Sipërm dhe gjithë Njësinë Administrative Pogon.

Të sigurojë kushte jetese dinjitoze për moshën e tretë dhe kujdesin social për individët dhe familjet në nevojë nëpërmjet realizimit të objektivave kombëtarë për moshimin, mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë, akses në shërbimet e Bashkisë, sidomos në fshatrat e thella, si edhe aplikimit dhe përfitimit nga projektet kombëtare dhe evropiane për këtë qëllim.

Përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së institucioneve arsimore, qendrave shëndetësore, abulancave të fshatrave, kujdes shëndetësor me ekip të lëvizshëm, duke qenë se zonat banohen nga mosha të mëdha, që kanë nevojë për asistencë dhe shërbime të vazhdueshme mjekësore.

Menaxhimi i mbetjeve urbane, duke e shtrirë shërbimin në 100% të teritorit, duke krijuar kushte për riciklimin e tyre dhe venddepozitimimin sipas standarteve më të përparuara.

Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr.22 datë 30.07.2018 “Mbi procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njërive të vetqeverisjes vendore”, nga ana jonë janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr.74, datë 21.12.2022, afatet dhe përgjegjësitë, lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Gjithashtu me Vendimin nr.02, datë 17.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë, pranë institucionit tonë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik(GMS), si dhe janë caktuar drejtuesit dhe përbërja e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve(EMP). Me shkresën Nr.87/1 prot. datë 17.01.2023, Ju është dërguar të gjithë EMP-ve, buxheti i vitit 2023; kalendari i PBA 2024-2026, i monitorimit të tij, si dhe

Vendimi i Kryetarit mbi përbërjen e GMS dhe EMP-ve.

Nga ana e GMS, në mbledhjet periodike të zhvilluara, janë vlerësuar situatat aktuale, realizimi i produkteve dhe aktiviteteve të kësaj periudhe dhe masat që janë ndërmarrë për të ardhmen. Gjithashtu është raportuar nga ana e drejtuesve të EMP, lidhur me monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën e vitit 2023, duke bërë krahasimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve me planin dhe me të njëjtën periudhë të vitit 2022, si edhe sa dhe si janë arritur dhe realizuar qëllimi, objektivat dhe treguesit për çdo program. Gjithashtu në këto mbledhje është paraqitur edhe problematika lidhur me kordinimin më të mirë të bashkëpunimit midis drejtuesve të programeve me kordinatorin dhe sekretarin e GMS. Mbi bazën e materialeve të paraqitura në GMS, është hartuar sipas udhëzimit, të cituar në krye të rubrikës, Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të vitit 2023, për të cilin kërkohet miratimi nga Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e muajit Shkurt 2024.

Të gjitha shpenzimet e realizura gjatë kësaj periudhe, në të gjitha programet e shpenzimeve që zbaton Bashkia jonë, janë brenda limitit të miratuar të shpenzimeve të çdo programi. Është bërë krahasimi i këtyre treguesve faktike me periudhën analoge të vitit të kaluar si dhe me treguesit e planifikuar për këtë periudhë. Nga ky proces i zhvilluar, u pa e nevojshme në këtë periudhë, marrja e masave dhe veprimeve korigjuese për rishpërndarje të fondeve buxhetore midis programeve, në funksion të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit 2022 dhe korrigjimit të nivelit të të ardhurave dhe shpenzimeve të trashëguara. Kjo u bë në funksion të arritjes së qëllimit dhe objektivave të çdo programi buxhetor. Konkretisht me vendimin nr.14, datë 23.03.2023, të Këshillit të Bashkisë janë bërë ndryshime në lidhje me buxhetin e miratuar, **duke shtuar të ardhurat** me 18.722 mijë lek, ku:

2.502 mijë lek shtesë për të ardhurat e veta të trashëguara të vitit 2022 (Kapitulli 5);

4.856 mijë lek nga transferta e pakushtezuar e trashëguar e vitit 2022, (Kapitulli 1)

2.421 mijë lek, nga rishikimi në rritje i të ardhurave të vitit 2023, (Kapitulli 5)

8943 mijë lek, të ardhura nga grante dhe ndihma ndërkombëtare, sipas projektit të Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë, për blerje makine teknologjike dhe kontejnerë, (Kapitulli 5),

duke rritur perkatesisht Shpenzimet në programet 04520, 05100, 01110, 10661 dhe 06260, në artikujt 230, 231 dhe 602. Gjithashtu me Vendimin e mësipërm u miratuan dhe transferime buxhetore, duke pakësuar shpenzimet në programet 04520 dhe 08220, në shumën 5.381 mijë lek, për investimet e kryera në fund të vitit 2022, që nuk mund të parashikoheshin gjatë hartimit të buxhetit dhe shtimin në po të njëjtën masë të shpenzimeve në programet 06260, 10430, 08220, etj. Ndërsa me Vendimin nr.38, datë 19.07.2023, u miratua përdorimi i fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile në masën 2.499 mijë lek, që do të përdoret për pastrimin e kanalit “AJ Jorgji”, Vrisera, për parandalimin e përmytjeve, si dhe miratimi i shtesave buxhetore nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe fondet e kontigjencës së K.Ministrave për rritjen e pagave, në shumën 8.730 mijë lek.

Gjithashtu me me Vendimin nr.46, datë 28.09.2023, të Këshillit të Bashkisë, janë kryer transferime buxhetore, pikërisht duke qënë në fazën përmyllëse të realizimit të buxhetit, të cilat u diktuan nga dinamika e realizimit të aktiviteteve ekonomike të Bashkisë, që synuan në pakësimin e investimeve prej 7.200 mijë lek në programin menaxhimi i mbetjeve urbane, si rezultat i përfundimit të realizimit të projektit japonez dhe aolkimin e këtyre investimeve në funksion të investimeve të tjera në vazhdim edhe për vitin 2024, konkretisht Shtesë për vlerën e investimit të këtij viti, në objektin “Rikonstruksion i rrugës Terihat – Sofratikë“, në vlerë 3.537 mijë lek; Supervizimin dhe kolaudimin e investimit për Rikonstruksion banesash, në kadër të përfitimit nga Programi i

Strehimit Social për permiresimin e kushteve të banimit të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara në vlerën 163 mijë lek, si edhe shpenzime operative për ndriçimin publik në masën 800 mijë lek dhe 500 mijë për të mbështetur akademinë sportive Lefter Millo

RELACIONE SPJEGUESE.

Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2023.

Të ardhurat nga burimet e veta përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe grante e sponsorizime. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2023 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve dhe shërbimeve ndaj komunitetit dhe individit.

Objektivat sipas programit të Kryetarit të Bashkisë, kryesisht janë të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, duke ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit,. Gjithashtu dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesve nëpërmjet zyrave postare, si agjent tatimor të shpërndara gjeografikisht në territorin e Bashkisë pranë komunitetit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshme të marrëdhënies me taksapaguesin



Mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë Njësive Administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit. Keto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqeruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesit familjarë, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Objektiv i rëndësishëm ka qene saktësimi dhe zgjerimi i regjistrave të kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye u ushtruan verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesore të të ardhurave. Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me agjentë tatimorë. Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore

Të ardhurat totale nga burimet e veta vendore për vitin 2023, u realizuan në vlerën 270.381 mijë mijë lek, kundrejt planit të ndryshuar prej 291.997 mijë lek, ose 92,6% me nje mosrealizim ne masen 21.616 mijë lek, ndërsa krahasuar me vitin e mëparshëm, realizohen në masën 104,6%, ose 11.791 mijë lek më tepër. Ndikim ka dhene mosrealizimi i te ardhurave nga burimet e veta (79,6%) dhe brenda tyre, të tjera, grante dhe ndihma ndërkombëtare, në vlerën 11.691 mijë lek; taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja, në vlerën 4.939 mijë lek; të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve 322 mijë lek, shitja e aseteve fikse prej 815 mijë lek, si edhe mosrealizimi i pjeses se te ardhurave nga tarifat per pyjet dhe kullotat në vlerën 1.681 mijë lek.

A. TE ARDHURAT E VETA VENDORE (000/lek)	84.389
Te ardhura nga taksat lokale	20.872
Te ardhurat nga taksat e ndara	7.546
Te ardhura nga tarifat vendore	22.489
Te ardhura te tjera	33.482
B. TË ARDHURA NGA BUXHETI QËNDROR	166.784



Nga transfertat e pakushtëzuar	114.858
Nga transfertat specifike	51.926
C. NGA TRASHËGIMI I VITIT TË KALUAR	19.208
TOTALI A+B+C	270.381



Nga sa shikohet në paraqitjet grafike të mësipërme, pjesa më e madhe e burimeve buxhetore (të ardhurat) janë nga buxheti qendror, (të cilat janë të detyrueshme në bazë të ligjit) dhe janë në rritje nga viti në vit. Gjithashtu vërejmë se nga të tre vitet, në vitin 2023, kemi arritur nivelin më të lartë të realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurave nga buxheti qendror, ndërsa tek zëri, trashëgim

nga viti i kaluar shikojmë uljen e vazhdueshme nga viti në vit, gjë që tregon planifikim dhe realizim më të lartë shpenzimesh nga viti në vit

Në të ardhurat nga **burimet e veta vendore** përfshijnë të ardhurat nga taksat lokale, nga taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhurat nga burime të tjera. Në të ardhurat e veta të realizuara gjatë vitit 2023, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat e tjera me 40%; të ardhurat nga tarifat me 26%; të ardhurat nga taksat vendore me 25% dhe të ardhurat nga taksat e ndara me 9% të totalit.



TE ARDHURAT VITI 2023						
NR	LLOJI I TE ARDHURES	REALIZIMI 2022	REALIZIMI 2023	Plani 2023	DIF PL/FK	DIF 22/23
A	TE ARDHURA NGA BURIMET E VETA	59.698	84.389	106.005	-21.616	24.691
A.1	TE ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	24.683	20.872	26.673	-5.801	-3.811
A.1.1	TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TE VOGEL	50	20	0	20	-30
A.1.2	TAKSA MBI PASURINE E PALUAJSHME				0	0
A.1.2.1	TAKSA MBI NDERTESEN	9.339	9.137	9.500	-363	-202
A.1.2.2	TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE	7.889	7.758	7.800	-42	-131
A.1.2.3	TAKSA MBI TRUALLIN	2.686	2.403	2.800	-397	-283
A.1.3	TAKSA VENDORE NE SHERBIMIN HOTELIER	121	113	123	-10	-8
A.1.4	TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA	3.613	511	5.450	-4.939	-3.102
A.1.5	TAKSA E TABELS	985	930	1.000	-70	-55
A.2	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	6.676	7.546	6.920	626	870
A.2.1	TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE/PASURITE E PALUAJTSHME			100	-100	0
A.2.2	TAKSA VJETORE PER QARKULLIMIN E MJETEVE TE PERDORURA	4.188	4.379	4.200	179	191
A.2.3	TAKSA E RENTES MINERARE	2	1	120	-119	-1
A.2.4	TAKSA MBI TE ARDHURAT PERSONALE	2.486	3.166	2.500	666	680
A.2.5	TAKSA TE TJERA			0	0	0
A.3	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	23.223	22.489	26.154	-3.665	-734
A.3.1	TARIFA ME MENAXHIMIN E MBETJEVE				0	0
A.3.1.1	TARIFA E PASTRIMIT PER FAMILJET	4.684	4.720	5.200	-480	36
A.3.1.2	TARIFA E PASTRIMIT PER INSTITUCIONET	260	260	260	0	0
A.3.1.3	TARIFA E PASTRIMIT PER BIZNESIN	7.863	7.574	7.700	-126	-289
A.3.2	TARIFA PER NDRICIM PUBLIK	843	832	1.000	-168	-11
A.3.3	TARIFA PER SHERBIMET ADMINISTRATIVE TE BASHKISE				0	0
A.3.3.1	TARIFA PER SHERBIMET ADMINISTRATIVE TE BASHKISE	1.975	2.082	1.914	168	107
A.3.4	TARIFA TE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT			0	0	0
A.3.5	TARIFE PER RREGJISTRIM BIZNESI	67	36	50	-14	-31
A.3.6	TARIFA VENDORE PER URBANISTIKEN	952	223	1.300	-1.077	-729
A.3.7	TARIFA E LICENSIMIT TE VEPRIMTARIVE TE TRANSPORTIT	70	159	100	59	89
A.3.8	TARIFA E PARKIMIT PER MJETET E LICENSUARA DHE VENDPARKIME PUBLIKE	133	140	100	40	7
A.3.9	TARIFA PER DHENIE LICENSE PER TREGETIMIN E NAFTAES BRUTO DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ	1.329	1.267	1.000	267	-62
A.3.10	TARIFA PER PYJET DHE KULLOTAT	3.482	3.549	5.230	-1.681	67
A.3.11	TARIFA PER SHERBIMET SHTESE NGA ZJARREFIKESJA	58	88	200	-112	30
A.3.12	TARIFE PER ZENIEN E HAPESIRES PUBLIKE			100	-100	0
A.3.13	TARIFA PER SHERBIMIN E UJITJES DHE KULLIMIT	1.040	1.135	1.500	-365	95
A.3.14	TARIFA TE TJERA(sh/v)	467	424	500	-76	-43
A.4	TE ARDHURA TE TJERA	5.116	33.482	46.258	-12.776	28.366
A.4.1	QERAJA NGA ASETET NE PRONESI TE BASHKISE	162	276	231	45	114
A.4.2	SHITJA E MALLARAVE DHE SHERBIMEVE	112	4.732	5.054	-322	4.620
A.4.3	KUDRAVJATJET ADMINISTRATIVE(GJOBAT)	489	461	500	-39	-28
A.4.4	GRANTE DHE NDIHMA NDERKOMBETARE	1.662	27.252	38.943	-11.691	25.590
A.4.5	SHITJA E ASETEVE FINANCIARE	642		0	0	-642
A.4.6	SHITJA E ASETEVE FIKSE TE PREKSHME/ PAPANREKSHME	2.049	685	1.500	-815	-1.364
A.4.7	TE TJERA		76	30	46	76
B	TE ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	159.798	166.784	166.784	0	6.986
B1	Transferta e pakushtezuar	124.770	114.858	114.858	0	-9.912
B2	transferta e kushtezuar	0	0	0	0	0
B2.1	Per funksionet e deleguara				0	0
B2.2	Per projekte te vecanta				0	0
B3	Transferta e pakushtezuar sektoriale	35.028	51.926	51.926	0	16.898
C	HUAMARRJA				0	0
D	TRASHEGIMI NGA VITI I SHKUAR				0	0
D1	trashegimi me destinacion				0	0
D2	trashegimi pa destinacion	39.094	19.208	19.208	0	-19.886
	TOTALI I TE ARDHURAVE (A+B+C+D)				0	0
		258.590	270.381	291.997	-21.616	11.791

Nga tabela se mesiperme kemi : **Taksat Lokale** realizimi ne masen 78% kundrejt planit. Mosrealizimi vjen nga taksa e ndikimit ne infrastrukture, e cila eshte arritur vetem ne masen 9%, per shkak te mos

miratimit nga KRRTRSH të PPV të Bashkisë, mospasjes së kërkesave të reja për leje ndërtimi, si edhe mospërfundimit të afatit të lejeve të ndërtimit për bizneset e mëdha që operojnë, të cilat e kanë paguar këtë lloj takse në vitet e mëparshme dhe nga taksa mbi truallin, e cila është realizuar 86 % .

Te ardhurat nga taksat e ndara, realizimi 109% ,kemi tejkalim kryesisht tek zëri, taksa mbi të ardhurat personale (vjen nga DPT), si rezultat i rritjes së pagave gjatë vitit 2023.

Te ardhurat nga tarifat vendore, shohim nje mosrealizim te planit. Me konkretisht është aritur realizimi ne masen 86% te planit..Mosrealizimi vjen nga mosvjelja e tarifave per pyjet dhe kullotat (68%). Gjithashtu kemi dhe nje mosrealizim ne tarifen vendore të urbanistikës në masën 1.077 mijë lek, pasi kjo tarifë është e lidhur ngushtësisht me lejet e reja të ndërtimit, edhe pse nga ana e Agjensisë së Kadastrës nuk kërkohet më shkresë përcjellëse për verifikimin e pasurive për kërkesat për hipotekim të qytetarëve.

Tek pjesa e katert e tabelës ne te cilën janë **te ardhurat e tjera** shohim nje diference më te madhe midis realizimit dhe planit . Realizimi është arritur vetem ne masen 72% dhe kjo vjen nga zeri, **Grante dhe ndihma ndërkombëtare**, ku nga 38.943 mijë lek, realizojmë vetëm 27.252 mijë lek. Fondet për projektet ndërkufitare të përfunduara, nuk janë disbursuar brenda vitit 2023 dhe do të jenë si të ardhura shtesë për vitin 2024; **shitja e mallrave dhe shërbimeve** e cila ka nje realizim 93.6% . Keto janë te ardhurat qe ishin planifikuar te realizoheshin nga shitja e druve te zjarrit per komunitetin. Mosrealizimi i vogël i tyre ka ardhur nga diferenca në prokurimin e shërbimit , ndërsa shitja e tyre populates, bëhet gjithmonë me koston e këtij shërbimi.

Gjithashtu edhe tek zeri “shitja e asetëve fikse të prekshme/paprekshme”, shohim qe gjate vitit 2023, kemi pasur te ardhura vetem 685 mije lek, ose 42%, kjo e fundit pasi akoma Bashkia jonë nuk ka PPV të miratuar, rrjedhimisht pengohet me ligj shitja e trojeve. Realizimi në këtë masë, është vetëm për trojet e dhëna në periudhën para vitit 2005, me vendime të ish këshillave të komunave, që nuk ishin paguar totalisht në atë kohë

II. Realizimi i shpenzimeve.

Duke analizuar Aneksin 1, **Raporti i shpenzimeve sipas programeve nga burimet e veta** (ardhurat e veta, transferata e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe të ardhurat e trashëguara), (bashkangjitur), shikojme se per totalin e programeve buxhetore (gjithsej 15), gjate vitit 2023 realizuam gjithsej 237.547 mije lek ne fakt, nga 280.404 mije lek në plan (i ndryshuar) ose 84.7%. Ne qofte se realizimin e shikojme ne krahasim me vitin e kaluar 2022, jemi ne masen 99.2%, kjo e fundit per shkak te diferences ne vleren e projekteve te investimeve ne programin e rrugëve rurale (04520) që kanë të bëjnë me investimet tek projektet interreg (pjesa e bashkëfinancimit). Si edhe investimeve nga projektet interreg në programin shërbime kulturore (08220), përsëri pjesa e bashkëfinancimit tonë.


Ndërsa duke analizuar **realizimin e shpenzimeve nga transfertat e kushtëzuara** (financim projektesh nga ministri dhe agjensi të linjës dhe **funksiione të deleguara** (gjëndje civile, zgjedhjet, kujdesi social PAK dhe NE) për shtatë programet buxhetore gjate vitit 2023 realizuam gjithsej 436.499 mije lek ne fakt, nga 449.522 mije lek në plan, ose 97.1%. Ne qofte se realizimin e shikojme ne krahasim me vitin e kaluar 2022, jemi ne masen 179 %, kjo e fundit per shkak te diferences ne vleren e projekteve te investimeve në ujësjelles kanalizime te akorduara nga Agjensia e Ujësjellës Kanalizimeve për veprat në vazhdim dhe përfundimin e investimeve, si Ujësjellës nga burimi i Manxifës dhe Rikonstruksioni i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë,

Krioner, Faza II; Rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm të ujësjellësave për fshatrat Dervician, Sofratikë dhe Terihat; Rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm të ujësjellësave për fshatrat Zervat, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Goricë, Frashtan, Lugar dhe Grapsh. Vlera e këtyre investimeve është për këtë periudhë (2023), 335.286 mijë lek. Gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi shpenzime të rritura në funksionin e gjëndjes civile për shkak të rritjes së pagave, por ulje të shpenzimeve në programin e PAK dhe NE (nga MSHMS), për shkak të pakësimit të numrit të përfituesve. Gjithashtu kemi rritje të investimeve në programin e mbrojtjes civile (fondi i emergjencave Civile, Ministria e Mbrojtjes), për shkak të investimit në veprën mbrojtëse nga përmytjet e Përroit të fshatit Selo, faza e parë me vlerë 27.231 mijë lek;, si edhe Përmirësimi i kushteve të banesave në programin e strehimit social (MFE) prej 2.845 mijë lek, etj.

Të dhënat e shpenzimeve nga plan, plan i rishikuar dhe fakt, sipas Programeve buxhetore nga burimet e kushtezuara/delegura, janë paraqitur në Aneksin , si me poshte:

TRANSFERTAT E KUSHTEZUARA, DELEGUARA								ne 000/leke
Emri i Grupit						Kodi i Grupit		2452001
Programet		Shpenzimet e Bashkise DROPULL						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2022	Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani progresiv 2023	progresiv 2023	
								0,0
01170	Gjendje civile	2.588,7	0,0	0,0	3.339,8	3.339,8	2.997,3	-342,5
01620	Zgjedhjet	0,0	0,0	0,0	1.378,2	1.378,2	1.367,2	-11,0
06190	Strehimi	0,0	0,0	0,0	2.844,6	2.844,6	2.844,6	0,0
06370	Furnizimi me uje	176.523,2	0,0	0,0	335.285,9	335.285,9	335.285,8	-0,1
09230	Arsimi i Mesem	25.029,1	0,0	0,0	30.444,1	30.444,1	30.444,1	0,0
10430	Kujdesi social(PAK+NE)	37.623,2	0,0	0,0	34.458,0	34.458,0	33.362,1	-1.095,9
10910	Mbrojtje civile	2.601,4	0,0	0,0	41.771,9	41.771,9	30.197,6	-11.574,3
Totali i Shpenzimeve te Bashkise		244.365,5	0,0	0,0	449.522,5	449.522,5	436.498,8	-13.023,8
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								0,0
Totali		244.365,5	0,0	0,0	449.522,5	449.522,5	436.498,8	-13.023,8


Struktura nga transf.kushtez./deleguara



Klasifikimi i shpenzimeve nga transfertat e kushtezuara, te deleguara 2023, (000/LEK)

		Plan	Fakt
600	Pagat; sigurime shoqerore	5658	5166
602	Shp.Operative	2499	2164
230/231	Investime	406908	395806
606	Kujdesi per individet	34458	33363
	TOTALI	449523	436499

Shpenzimet nga transf. E kushtezuara/te deleguara




■ Paga, sigurime shoqerore ■ Operative ■ Transferta per individe ■ Investime

Ne qofte se analizojmë ecurinë e **shpenzimeve nga burimet e veta**, sipas grup-artikujve, d.m.th. shpenzime per paga dhe sigurime shoqerore; shpenzime per mallra dhe sherbime te tjera; transferta tek te tjeret dhe individe dhe studime, projekte dhe investime (600+601; 602; 604; 606; 230-231), do te kemi panoramen e meposhtme

Klasifikimi i shpenzimeve nga burimet e veta sipas artikujve, 2023 (000/LEK)

		Plan	Fakt
600	Pagat	109.309	98.973
601	SigurimeShoqerore	18.280	16.454
602	Shp.Operative	68.577	52.149
230/231	Investime	72.113	64.294
606	Kujdesi per individet	3.625	3.177
604/609	Transferta të brendshme, emergjenca	8.500	2.500
TOTALI		280.404	237.547

Shpenzimet nga burimet tona



Nga sa me lart verrehet se: shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore, perbejne 48.6% te totalit te shpenzimeve faktike; Shpenzimet per mallra dhe sherbime te tjera (shp. Operative) në 22%; Shpenzimet per transferta në 1,4%; Shpenzimet per investimet nga burimet tona në 27% dhe të tjera, në 1%

Të dhënat e shpenzimeve nga plan, plan i rishikuar dhe fakt, sipas Programeve buxhetore nga burimet tona, jane paraqitur ne Aneksin 1, si me poshte:


ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

BURIMET E VETA (ARDHURAT E VETA, TRANSF.PAKUSHTEZUAR, TRASHEGUARA)

ne 000/leke

Enri i Grupit		Kodi i Grupit						2452001
Programet		Shpenzimet e Bashkise DROPULL						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2022	Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani progresiv 2023	progresiv 2023	Diferenca
01110	Planif.menaxh.administrim	71.029,2	83.730,0	83.730,0	90.095,9	90.095,9	78.646,4	-11.449,5
03280	MZSH	13.374,3	16.371,0	16.371,0	17.084,8	17.084,8	16.849,3	-235,5
04240	Kullim-i-Ujitja	6.084,2	6.258,0	6.258,0	7.008,9	7.008,9	5.597,5	-1.411,4
04260	Pyje-Kullota	4.885,1	22.256,0	22.256,0	23.422,4	23.422,4	22.729,9	-692,4
04520	Rruge rurale	91.099,4	44.901,0	44.901,0	51.780,6	51.780,6	44.919,1	-6.861,5
04980	Fond emergjence, rezerve	0,0	6.000,0	6.000,0	6.000,0	6.000,0	0,0	-6.000,0
05100	Mbetje urbane	20.013,3	24.058,0	24.058,0	30.931,7	30.931,7	26.613,5	-4.318,2
06260	Sherbime publike	8.651,3	19.699,0	19.699,0	22.695,6	22.695,6	18.503,5	-4.192,1
06370	Ujesjelles-kanalizime	1.355,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
08220	Sherbime kulturore	11.399,5	3.400,0	3.400,0	1.380,0	1.380,0	1.058,0	-322,0
09120	Arsimi Baze	3.411,0	4.203,0	4.203,0	4.314,0	4.314,0	3.661,0	-653,1
09230	Arsimi i Mesem	3.625,0	17.476,0	17.476,0	17.885,1	17.885,1	15.227,3	-2.657,8
10430	Kujdesi social	4.454,3	3.400,0	3.400,0	4.815,0	4.815,0	3.596,3	-1.218,7
10661	Strehimi Social	0,0	1.200,0	1.200,0	1.603,0	1.603,0	145,3	-1.457,7
10910	Mbrojtje civile	0,0	0,0	0,0	1.387,0	1.387,0	0,0	-1.387,0
Totali i Shpenzimeve te Bashkise		239.381,6	252.952,0	252.952,0	280.403,9	280.403,9	237.546,9	-42.857,0
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								0,0
Totali		239.381,6	252.952,0	252.952,0	280.403,9	280.403,9	237.546,9	-42.857,0

Struktura e shpenzime ne 000/lek



Ne programin planifikim menaxhim,administrim (01110).

Qëllimi i këtij Programi është të përmirësojmë transparencën në administratën e Bashkisë, të risim përgjegjshmërinë e saj, si edhe shërbime cilësore ndaj qytetarëve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre me iniciativa dhe rekomandime ne ushtrimin e funksioneve te Bashkise. Kjo e fundit do të realizohet nëpërmjet objektivit të rëndësishëm të materializimit, pra të përfshirjes së iniciativave dhe propozimeve qytetare në vendimet e Këshillit Bashkiak, në Urdhërat e Kryetarit, si edhe në Rregulloret dhe veprimtaritë e tjera. Gjithashtu efikasiteti dhe transparenca në punën e administratës, që përkthehet në rritjen e shërbimeve ndaj qytetarit, ndaj komisioneve të Këshillit dhe Kryetarit, kërkon realizimin edhe të objektivit tjetër për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të administratës, rinovimin e vazhdueshëm rregulloreve,

përmirësimin e etikës së komunikimit, rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit midis Drejtorive dhe Sektorëve me Kabinetin, Këshillin Bashkiak dhe Organet Rajonale dhe Qendrore. Në shpenzimet korente, artikujt 600+601 (pagat dhe sigurimet shoqërore), realizohen në masën 116.2% në krahasim me vitin e kaluar dhe 88,9 % në krahasim me planin e vitit 2023. Realizimet e larta si në krahasim me planin dhe vitin e kaluar, kanë ardhur për shkak të rritjes së pagave tek punonjësit e administratës si rezultat i zbatimit të vkm-ve, nr.328 datë 31/05/2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të Këshillit të Ministrave nr. 326 datë 31/05/2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike. Po kështu janë realizuar shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera të këtij programi në masën 84.2 %, për shkak të diferencës së çmimeve në prokurimet e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për funksionimin e administratës vendore, Investimet e këtij programi, si ato për inventar ekonomik realizohen në masën 751 mijë lek nga 1200 mijë lek të parashikuara, ose 62,5%, si rezultat i diferencës në vlerën e prokurimeve. Me interes në këtë raport, është paraqitja brenda këtij programi, si dhe me vete të shpenzimeve të funksionimit të Këshillit të Bashkisë dhe të komisioneve të tij, në rolin e tij përfaqësues, vendimarrës dhe mbikqyrës. Kështu kemi një realizim të kënaqshëm të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve të Këshillit gjatë 2023. Kështu janë realizuar shpenzimet për pagesën e honorareve të këshilltarëve, Kryetarëve të Kryesive të fshatrave, të cilat realizohen në masën 94,9%; shpenzimet 600+601 të Sekretarës së Këshillit Bashkiak, 98,6%, etj. E gjithë veprimtaria e Këshillit Bashkiak, për vitin 2023, ka synuar rritjen e rolit të tij dhe sidomos fuqizimin e transparencies së veprimtarisë së këtij organi, organizimin e seancave degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, etj. Nuk kemi realizuar plotësisht për periudhën e vitit 2023, shpenzimet operative, që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve, trajnimeve dhe shkëmbimin e eksperiencave me organe analoge.

Në programin shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (03280).

Qëllimi i këtij programi është mbulimi me shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si edhe shërbimet e mbrojtjes civile në të gjithë teritorin të Bashkisë në mënyrë sa më efektive dhe në kohë sa më të shpejtë. Kjo krahas të tjerave presupozon arritjen e ekipeve të mbrojtjes dhe shpëtimin në skajet me të largëta nga vendstacionimi i tyre. Kjo kërkon gadishmëri të lartë, logjistike dhe një organizim operacional. Realizimi i qëllimit të mësipërm është bërë nëpërmjet objektivave dhe treguesve konkret, si përmirësimi i vazhdueshëm i efikasitetit të nderhyrjeve për rastet e zjarrit dhe nderhyrjeve për shpëtim, nëpërmjet rritjes së rasteve të nderhyrjeve dhe aftësisë reaguese ndaj emergjencave, nëpërmjet uljes së kohës së reagimit. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile vazhdon të konsolidohet nga viti në vit. Roli i këtij shërbimi edhe gjatë vitit 2023, për shkak të situatës së zjarreve, po vlerësohet më tepër, lidhur edhe me nderhyrjet dhe shërbimet e reja, për të ardhur në ndihmë komunitetit, sidomos atyre të zonave të thella. Duke qënë një shërbim rëndësishëm për Bashkinë tonë, pasi menaxhojmë një teritor prej 467 km², në pjesën më të madhe malor dhe pa infrastrukturë të përshtatshme (rrugë malore, breza antitermike, sisteme lumenjësh dhe përenjsh, etj), i kemi kushtuar rëndësi të madhe strukturimit të plote, rritjes së efikasitetit të nderhyrjeve dhe përballimit të emergjencave. Gjatë vitit 2023 realizuam një total shpenzimesh në masë absolute 3.475 mijë lek më tepër, ose 126%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (2022), dhe 98,6% në krahasim me planin e vitit, ose 236 mijë lek më pak dhe kjo pasqyrohet tek shpenzimet korente në këtë program. Brënda këtij grupimi të shpenzimeve, nuk janë realizuar shpenzimet e artikullit 602 (shpenzime materiale dhe shërbime) për shkak të pajisjeve të nderlidhjes, pasi u përdorën ato egzystuese. Gjithashtu janë realizuar investimet e parashikuara për blerjen e pajisjeve speciale në masën 240 mijë lek, ose 100%.

Në programin shërbimi i kullimit, vaditjes etj (04240).

Qëllimi përfundimtar i këtij Programi Buxhetor është rritja e zhvillimit ekonomik, bujqësor nepermjet administrimit efikas, shfrytëzimit maksimal dhe mirembajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Në funksion të tij janë burimet ujore të 16 rezervuarëve, 14 prej të cilëve janë funksionalë, ku në 11 prej tyre bëhen aktivitete mirëmbajtjeje. Gjithashtu Bashkia disponon një rrjet kanalesh kullues dhe vaditës, përkatësisht 1043km dhe 928 km. Për realizimin e aktiviteteve të këtij Programi buxhetor, krahas burimeve të tjera, janë edhe 10 punonjës dhe 5 të tjerë sezonalë (3M), si edhe dy mjete gjermuese. Nëpërmjet aseteve të cituara më lart, realizohen objektivat bazë, si,

- Përmirësimi i rrjetit ujites, rrjetit kullues, duke shtuar sipërfaqen bujqësore të mbuluar me shërbimet e ujitjes dhe kullimit.

-Administrimi efikas i rezervave ujore dhe i shërbimit të vaditjes, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i këtyre shërbimeve.

Produktet kryesore që realizohen dhe që thithin pjesën më të madhe të shpenzimeve janë ato të administrimit dhe monitorimit të burimeve ujore për shërbimin e vaditjes ndaj fermave bujqësore të vogla dhe të mëdha. Si edhe pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Kështu gjatë vitit 2023, i është kushtuar një vemëndje e veçande realizimit të shpenzimeve në mbështetje të këtij programi. Kështu në total shpenzimet e këtij programi janë realizuar në masen **79,8%** në krahasim me planin. Por kemi edhe mosrealizime të vogla tek shpenzimet e artikullit 602 (shpenzime materiale dhe shërbime) për shkak të diferencës në vlerën e prokurimeve. Puna e stafit të Drejtorisë së Administrimit të Ujit, Pyjeve, Kullotave duhet të synojë një nivel më të lartë se i deritanishmi, ku në bashkëpunim me fermerët dhe bizneset agrourbushqimore, që operojnë në teritorin tonë, të nxisi në kultivimin e kulturave të reja të drithrave dhe foragjereve me prodhimtari më të lartë, si dhe mbështetjen e tyre me informacione për teknologji të re, shërbime intesive, midis të cilave edhe vaditje të vazhdueshme gjatë periudhës së verës.

Në programin shërbimi pyjor (04260).

Qëllimi i funksionimit të këtij Programi Buxhetor është shfrytëzimi gjithnjë e më racional i pyjeve dhe kullotave për rritjen e cilësisë së shërbimeve pyjore-kullosore ndaj fermereve blegtoralë dhe komunitetit në përgjithësi. Bashkia jonë disponon një fond total të sipërfaqes pyjore-kullosore prej 23.000 ha. Numri i punonjësve të këtij Programi në funksion të rruajtjes së fondit të mësipërm, inspektimit dhe monitorimit të tij ka ardhur në rritje, në krahasim me vitet e kaluara. Realizimi i aktiviteteve në këtë Program ka për bazë objektivin për,

- Përmirësimin e inspektimeve të fondit pyjor dhe kullosor.

-Përmirësimin e cilësisë së shërbimit për furnizimin me dru zjarri të komunitetit rural.

Për vitin 2023, realizojmë një total shpenzimesh në masën 22.730 mijë lek, ose 4,6 herë më shumë se viti 2022 dhe 97% në krahasim me planin. Shpenzimet për paga dhe sigurime në këtë program janë në masën 7.868 mijë lek, ose 91% në krahasim me planin, kjo për shkak të riorganizimit më të mirë në këtë sektor, qysh vitin e kaluar me synim monitorimin më të plotë të sipërfaqes pyjore-kullosore, sidomos në Njësinë Administrative Pogon. Në realizimet e kënaqshme të këtij programi ndikimin më të madh e jep kategoria e shpenzimeve për blerje mallra dhe shërbime të tjera, që konsiston në artikullin 602 (prerje, magazinim i druve të zjarrit), në masën 5.054 mijë lek. Gjithashtu gjatë këtij viti u realizua prokurimi i investimit, shpenzime në artikullin 230, për hartimin e planeve 10-vjecare të mbareshtimit të pyjeve, të zonës pyjore-kullosore të Malit të Gjerë, në ekonominë pyjore nga fshati Goranxi deri në fshatin Grapsh, me qëllim, krahas të tjerave edhe me pjesëmarrjen në projektet Evropiane, si ato të IPA, por edhe ndërkufitare për rehabilitimin dhe shfrytëzimin efektiv të sipërfaqes pyjore, kullosore, në masën 9.809 mijë lek.

Ne programin rrugë rurale, rrugë të brëndshme dhe menaxhim të transportit rrugor. (04520).

Permiresimi i infrastruktures rrugore rurale duke mundesuar akses te plote te tyre ne rrjetin rrugor kombetar dhe nderkombetar, si dhe aksesueshmerine e komunitetit ne sherbimet vendore, përbën qëllimin e këtij Programi të rëndësishëm buxhetor. Qellimi, objektivat, aktivitetet e ketij Programi do të realizohen nëpërmjet burimeve, që janë fuqia punëtore për mirëmbajtje, mjetet dhe fondet përkatëse për prokurimin e investimeve. Ndër objektivat bazë, mund të veçojmë:

-Përmiresimi i sherbimit te mirembajtjes se rrugeve rrurale ne gjithë teritorin e Bashkisë.

- Ndërhyrje me investime per rikonstruksionin sipas standarteve te perparuara te segmenteve rrugore problematike.

-Ndërtime te reja rruges, me impakt ne nje pjese gjithnje e me te madhe te komunitetit.

Është programi kryesor në të cilin materializohen pjesa më e madhe e investimeve nga burimet tona të brendshme. Gjatë vitit 2023, këtij Programi Buxhetor, i është kushtuar një rëndësi më e veçantë, krahasimisht me programet e tjera. Përveç transfertës së pakushtëzuar sektoriale, në këtë program përdorim dhe të ardhurat e realizuara nga burimet tona dhe fondet e perfituara nga programet nderkufitare. Keshtu ne krahasim me planin realizojme nje total shpenzimesh ne masen 86.7%. Brënda totalit të shpenzimeve faktike, shpenzimet për investimet përbëjnë 69,4%. Shpenzimet per investime gjatë vitit 2023, realizohen në masën 87,6% në krahasim me planin. Vazhdon edhe gjatë kësaj periudhe synimi që krahas disa investimeve në zona të veçanda problematike, pjesa dërmuese e shpenzimeve kapitale të përqëndrohet në veprat, nga realizimi i të cilave përfiton një komunitet disafish më i madh, si investimi Rikonstruksioni i rruges ne Njesine Administrative Pogon me shtrese betoni, me vlere 2.909 mije lek; Mbrojtje e rruges me gabion ne peroin e fshatit Selo dhe muri mbajtes Koshovice ne vlere 1.493 mije lek; Rikonstruksioni i aksit rrugor Poliçan-Dhriomadhes me vlerë 10.000 mijë lek, projekt i cili do vazhdoje ne mase dhe ritme me te larta gjate vitit 2024 (përkatësisht 14.000 mijë lek); Rikonstruksioni i rrugës Sofratikë – Terihat, në vlerë 10.111 mijë lek, i cili pritet të përfundojë gjate vitit 2024 (përkatësisht 30.054 mijë lek). Gjithashtu do te vazhdoje gjate vitit 2024 perfitimi nga projektet IPA “Extroverd-Roads” për vazhdimin e Rikonstruksionit te rrugës hyrëse ne fshatin Bodrishtë. Shpenzimet për investime në veprat e cituara më lart, janë një mënyrë që të ardhurat nga burimet e veta të arkëtuara, të përdoren në funksion të rritjes së cilësisë së jetës së komunitetit tonë. Përveç shpenzimeve kapitale në këtë program kemi angazhuar edhe fuqi punëtore dhe shpenzime të tjera materiale për mirëmbajtjen e akseve rrugore, sidomos në zonat problematike të Njësive administrative Pogon dhe Dropull i Sipërm, që kanë si prioritet sigurinë e akseve të rrugëve rurale, si dhe ndërhyrjeve emergjente në periudhën e dimrit për përballimin e rreshjeve të debores dhe përmbytjeve. Realizimi i këtyre shpenzimeve per vitin 2023 paraqitet në masën 84.8% në krahasim me planin. Kjo ka ardhur si rezultat i ofertave më të ulëta në prokurimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, por edhe se kontrata e mirëmbajtjes së rrugës së Pogonit përfundon në muajin Maj të vitit 2024.

Në programin e shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve urbane (05100).

Është nga programet më të rëndësishme buxhetore të shërbimeve publike, ku i shërbehet në mënyrë direkte komunitetit të banorëve, biznesit dhe institucioneve. Realizimi i aktiviteteve të këtij Programi, përveçse ka impakt në cilësinë e jetës së banorëve, ndikon në mënyrë të efektshme në rruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të habitateve natyrore, si edhe zhvillimin ekonomik nëpërmjet nxitjes dhe promovimit të turizmit në të gjitha format e tij.

Qëllimi i këtij Programi buxhetor është përmiresimi i vazhdueshëm i ofrimit te shërbimit te menaxhimit të mbetjeve urbane, por edhe rurale për kushtet e Bashkisë tonë, si edhe pastrimin e rrugëve, shesheve dhe parqeve publike, sidomos qëndrat e fshatrave dhe rreth rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi.

Pikërisht ky qëllim do të arrihet nëpërmjet objektivave dhe aktiviteteve konkrete, që lidhen me permiresimin e grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane, që përfshin edhe trajtimin e mëtejshëm mjedisor në vënddepozitimin, në rritjen e pikave të grumbullimit nëpër fshatra dhe biznese, si edhe në rritjen e frekuencës javore, sidomos në pikat e nxehta dhe në periudhën e Gushtit dhe të festave tradicionale në fshatrat tanë. Përveç punëtorëve të kualifikuar, në mbështetje të këtij shërbimi janë edhe dy mjete teknologjike, si edhe dy mjete të tjera, të cilat operojnë jo vetëm në qëndrat, por edhe në lagjet e skajshme të fshatrave. Krahas fondeve nga burimet e veta, që alokon Bashkia në këtë program, përdorim duke filluar nga viti 2023, edhe transfertën specifike për këtë qëllim, në kuadër të planit kombëtar për një mjedis të pastër. Kështu për vitin 2023, përveç fondeve nga të ardhurat nga shërbimi i pastrimit përdoren edhe 14.400 mijë lek nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve urbane, tendencë që do vazhdojë edhe në vitet e PBA 2024-2026, ku edhe për vitin 2024 aktualisht na kanë ardhur 14.692 mijë lek. Të gjitha këto krahas të tjerave, synojnë në mbulimin e gjithë teritorit të Bashkisë, edhe në fshatrat më të thella, në rritjen e familjeve përfituese nga ky shërbimi nga viti në vit, por edhe rritjen e sipërfaqeve publike të pastruara, por edhe aktivitete informuese ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit urban dhe rural. Në total realizimi i shpenzimeve të këtij programi në krahasim me planin është në masën 86,1%, ndërsa në krahasim me vitin 2022, është 133%. Brenda këtij programi kemi edhe realizimin e investimit në vlerën 11.004 mijë lek për blerjen e një mjeti teknologjik dhe kontenjerë në bashkëfinancim me grantin japonez. Ndikim në mosrealizimin e totalit të shpenzimeve kanë dhënë kryesisht shpenzimet korente dhe brenda tyre shpenzimet për shërbimin e mirëmbajtjes së mjeteve, ku kursimi rezultoi, pasi kontrata e mirëmbajtjes shtrihet deri në Qershor 2024, si dhe nga diferenca e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar. Rritja e performancës në mbledhjen e të ardhurave nga vendosja e tarifave në shërbimin e pastrimit (ku vazhdojmë edhe për vitin 2023 të kemi rritje, do të shkojë paralelisht me rritjen e cilësisë së shërbimeve të mësipërme dhe rritjes së aksesit të gjithë komunitetit të Bashkisë në to.

Në programin e shërbimeve publike (06260).

Pas Programit të menaxhimit të mbetjeve urbane, është programi i dytë më i rëndësishëm i shërbimeve ndaj komunitetit, që lidhet me rekreacionin, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese. Me përmirësimet e vazhdueshme të infrastrukturës, është synuar rijetëzimi i hapësirave publike, sidomos gjelbërimi, mbjellja e luleve, shkureve dekorativë, si edhe mirëmbajtja dhe trajtimi i trotuarëve në fshatrat që egzistojnë.

Kështu Qëllimi i këtij Programi buxhetor mbetet përmirësimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, i shërbimit të ndriçimit publik, me ndikim në sigurinë publike dhe cilësinë e jetës komunitare, që realizohet nëpërmjet objektivave dhe aktiviteteve për:

-Rritja e cilësisë së mirëmbajtjes së shesheve dhe hapësirave publike, si sheshet e fshatrave, këndeve të lojrave, parqeve të vogla, trotuarëve.

-Rritja e cilësisë së ndriçimit publik dhe kursimit të energjisë elektrike nëpërmjet instalimit të ndriçuesve dhe aksesorëve të rinj.

- Rritja e cilësisë së mirëmbajtjes së varezave publike dhe kryerjes së investimeve modeste për zgjerrimin dhe rikonstrukcionin e tyre në fshatra të veçantë.

Shpenzimet e përgjithshme të këtij programi, për vitin 2023, realizohen në masën 81,5% në krahasim me planin, ku brenda tyre, ato korente, në masën 81.1%, ndërsa vetëm shpenzimet materiale në masën 78.2%. Kjo e fundit ka ardhur si rezultat i ndjekjes sistematike të shpenzimeve operative, sidomos tek shërbimet e prokuruar, si edhe ato për konsumin e energjisë elektrike për ndriçimin rrugor. Në vitin 2023

ne këtë program kemi realizuar edhe investimin për zgjerrimin e varrezave në fshatin Frashtan, në vlerë 517 mijë lek.

Në programin Furnizimi me ujë, ujesjelles-kanalizime (6370).

Eshte programi me i rendesishem per Bashkine tone dhe ka te beje kryesisht me investimet qe kryejme në Ndermarrjen Ujesjelles-Kanalizime sh.a., me synimin perfundimtar furnizimin me uje pa nderprerje per 95% te familjeve te Bashkise deri ne fund të vitit 2025. Pikërisht, garantimi i furnizimit me uje te pijshem pa nderprerje te gjithë abonenteve familjare, biznesit dhe institucioneve ne te tria Njesite Administrative te Bashkise, përbën dhe qëllimin e vetëm të këtij Programi Buxhetor. Kjo realizohet nëpërmjet objektivave konkretë dhe treguesve të performancës, që kanë të bëjnë me:

-Permiresimi i ofrimit te sherbimit te furnizimit me uje te pijshem ne cilesi dhe kohezgjatje per te gjithë abonentet.

-Rritjen e numrit të abonentëve përfitues të shërbimit

-Rritjen e kontrollit të cilësisë së parametrave të ujit të pijshëm

-Rritjen e kohëzgjatjes mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm

-Rritjen e të ardhurave nga abonentët nëpërmjet menaxhimit efikas të këtij shërbimi.

Meqenese keto shpenzime raportohen nga Agjensise Kombetare te Ujesjelles Kanalizimeve dhe Infrastruktures se Mbetjeve, nuk i kemi praqitur ne Aneksin 1, por në atë plotësues. Kështu sipas këtij të fundit janë realizuar për vitin 2023, fonde nga Agjensia, e cituar më lart për përfundimin e objekteve të investimeve, në vlerën 335.286 mijë lek, për projektet, si më poshtë për:

- Furnizimin me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal të Dropullit të Poshtëm.

-Ujësjellësin nga burimi i Manxifës dhe rikonstruksioni i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner.

-Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të fshatit Dervician-Sofratikë- Teriha.

-Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Goricë, Frashtan, Lugar dhe Grapsh.

Ne Programin Sherbime kulturore, (08220)

Eshte program buxhetor relativisht i ri per Bashkine tone, qe funksionon si i tille nga viti 2020. Puna dhe eksperiencia e fituar ne vitet 2020-2023, si edhe kualifikimi i vazhdueshem i stafit te ketij programi, do ti sherbejne ngritjes së nivelit artistik të aktiviteteve te ketij sherbimi, me synim promovimin dhe aksesueshmerine e veprave të trashëgimise kulturore dhe resurset e tjera turistike, duke rritur ekonomine vendore dhe mireqenien e komunitetit, forcimin e identitetit të vecande te krahines se Dropullit dhe Pogonit. Si qëllimin bazë të këtij Programi Buxhetor, mund të përmëndim gjallerimin e jetes se komunitetit dhe zhvillimin kulturor e sportiv, zhvillimin e turizmit, permes aktiviteteve, mbrojtjes se trashëgimise, rruajtjes se traditave, ngjarjeve historike, etj. Gjithashtu per vitin 2024 dhe vitet e tjera te PBA 2024-2026, planifikojme shpenzime te rritura materiale, si edhe ato per personelin per aktivitetet e Bibliotekes ne Dervician, te Qendres se Polifonise ne Grapsh dhe muzeun tradicional te prodhimit dhe ruajtjes se djathit.

Objektiv konkret do të jetë permiresimi i jetes kulturore dhe i aktiviteteve promovuese me fondet e Bashkise, nëpërmjet:

-Rritjes së numrit të aktiviteteve kulturore , eventeve sportive, njohjen, aksesueshmerine dhe mirembajtjen e monumenteve te kultures dhe te trashëgimisë, etj.

- Rritjen e numrit të pjesëmarrësve, sidomos te rinisë në aktivitetet dhe eventet e organizuara.

Keshtu ne total shpenzimet e ketij programi realizohen ne masen 76.5%. Ndikim krahas aktiviteteve te shumta te zhvilluara kane dhene perfundimi i e projekteve nga programet nderkufitare INTEREG,

konkretisht te programit “POLYPHONIA” dhe “CLLD-TOURS”, te cilat kane gjalleruar jeten social-ekonomikedhe krijimin e kushteve per rritje te ekonomise vendore nepermjet shtimit te produkteve nga agroturizmi. Krijimi i Akademisë sportive të Futbollit Lefter Millo dhe mbështetja me transfertë të brendshme fondesh, ka ndikuar në një interesim të lartë të nxënësve të shkollave, por edhe të komunitetit të prindërve dhe më gjerë, duke shfrytëzuar edhe donacione nga aktorë të tjerë për të aktivizuar të rinjtë dhe edukimin sportiv të komunitetit, si edhe mirëmbajtjen e tereneve sportive, etj

Programi arsimit bazë dhe i mesëm (9120; 9230).

Vecoria e funksionimit të sistemit arsimor në Bashkinë tonë, ku operojmë me Shkollën e Mesme të Bashkuara (pra me një menaxhim drejtues dhe teknik dhe një godinë, arsimin bazë dhe të mesëm), krijon ndërthurje të aktiviteteve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes dhe investimeve të përbashkëta në të dyja programet 09120 dhe 09230.

Qëllimi dhe objektivat e **arsimit bazë** kanë si drejtim frekuentimin gjithnjë e më të lartë të kopshteve, duke krijuar kushte sa më të mira për edukimin dhe mbarevajtjen e fëmijëve, nëpërmjet rritjes së shpenzimeve për kushte gjithnjë e më të përmirësuara materiale dhe ato për rritjen e cilësisë së edukimit të fëmijëve në kopshte. Përgjatë këtyre viteve, krahas trajnimit të vazhdueshëm të edukatoreve, është synuar një mjedis komod dhe didaktik për fëmijët në të tria kopshtet që administron Bashkia, duke rritur nga viti në vit numrin e fëmijëve të akomoduar. Kjo arrihet nëpërmjet rritjes së përqindjes së thithjes së fëmijëve të këtyre grupmoshave dhe përgatitjes së tyre për arësimin fillor.

Tek **arsimi bazë dhe parashkollor** (9120), realizimi në total i shpenzimeve në krahasim me planin paraqitet në masën 84,8%, të cilat për vitin 2023, janë të gjitha shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, pasi shpenzimet materiale dhe ato të mirëmbajtjes etj, janë të përbashkëta me programin 09230.

Qëllimi dhe objektivat e **Arsimit të Mesëm**, përcaktojnë krijimin e kushteve sipas standarteve për një edukim cilësor në rritje të nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Kjo krahas të tjerave kërkon rritjen e shpenzimeve për kushte gjithnjë e më komode materiale, me ndikim në rritjen e cilësisë së edukimit të nxënësve. Të gjitha këto do të synojnë rritjen e frekuentimit, si dhe rritjen e përqindjes së përhithjes së nxënësve nga shkolla 9-vjeçare në shkollën e mesme.

Me interes dhe ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimit të këtij funksioni është Realizimi nga Ministria e Arsimit, të fondeve për "Rikonstruksionin e Shkolles së Mesme të Bashkuar dhe Kopshtit në fshatin Bularat të Njesisë Administrative Dropull i Siperem. Është nisur zbatimi i këtij projekti gjatë vitit 2022, ku është realizuar një fond prej 25.029 mijë lek dhe ka përfunduar gjatë vitit 2023, me një vlerë tjetër prej 46.187 mijë lek, ku Brenda tyre edhe fondi prej 1.849 mijë lek për mobilimin e kësaj shkolle të rikonstruktuar. Theksojmë se kontributi i Bashkisë në këtë vepër është bashkëfinancimi në vlerë 10.667 mijë lek, që u realizua përgjatë vitit 2023. Gjithashtu tek programi i arsimit të mesëm (9230) realizimi i shpenzimeve paga, sigurime shoqërore, (sekretarët) realizohet në masën 95.6%. Në shkollat tona të mesme të bashkuara, janë kryer të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes dhe ato të furnizimit me mallra, sidomos ato për ngrohjen e abjentëve shkollorë në periudhën e dimrit. Shpenzimet për mallrat dhe shërbimet e blera (602) paraqesin një mosrealizim tek programi 9230 (arsimi i mesëm), në masën 55.9%, për arsye të diferencës së çmimeve të mallave dhe shërbimeve të prokuruar, si edhe moskryerjes së disa shërbimeve për mirëmbajtje në shkollën e mesme Bularat, për shkak të rikonstruksionit të godinës gjatë vitit 2023. Në këto shpenzime, krahas atyre të trajtuara më lart, përfshihen edhe shpenzimet për transportimin e nxënësve dhe mësuesve me mjetet e përshtatshme për këtë qëllim nga ana e Bashkisë (pagat dhe shpenzimet materiale).

Në programin e shërbimeve të kujdesit social (10430).

Si fillim, theksojmë se nga ana e Bashkisë po punohet për evidentimin e plotë të familjeve dhe individëve në nevojë dhe trajtimin e tyre nga skemat e mbështetjes shoqërore, me fonde të planifikuara nga burimet tona të brendshme. Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe dinjitetit, të të gjitha kategorive të familjeve dhe individëve në nevojë dhe mbështetja me skemat e perkujdesit në harmoni me politikat kombëtare, përbën qëllimin kryesor të këtij Programi Buxhetor, i cili arrihet nëpërmjet objektivave dhe treguesve realë, që kanë të bëjnë me:

-Evidentimin e të gjitha kategorive të familjeve dhe individëve në nevojë dhe përfshirja e tyre në skemat e perkujdesit social.

-Ulja e numrit të personave përfitues të aftësisë së kufizuar, riaftësimi dhe rifutja në jetën aktive duke mundësuar punësimin e tyre.

-Rritjen e përvitshme të përfituesve të personave dhe familjeve në nevojë nga fondi mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike.

-Përfshirjen e gjithë kategorive të përmendura më lart, në programet e rehabilitimit dhe formimit profesional, me synim jetën aktive dhe punësimin.

Gjatë vitit 2023 shpenzimet e këtij programi **nga burimet tona** realizohen në masën 74.7%, në krahasim me planin. Duhet të theksojmë se realizimi i shpenzimeve të këtij programi mundësojnë një nga objektivat bazë të Bashkisë, që është mbështetja sociale e familjeve dhe individëve në nevojë. Duke pasur parasysh se problemet sociale të komunitetit tone për shkak të emigrimit dhe moshës mesatare relativisht të lartë vazhdojnë të thellohen, puna e organeve të Bashkisë vazhdon të mbulojë edhe këto pasoja, që nga mbështetja me pako ushqimore, sanitare dhe shpërndarje medikamentesh dhe deri tek mbështetja me mjete financiare për individët dhe familje në nevojë ekstreme. Kështu në shpenzimet e realizuara në këtë program, përfshihet edhe fondi nga Bashkia, për fondin shtesë, mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike në vlerën 2.952 mijë lek, ose 100,2% në krahasim me vitin e kaluar 2022. Kjo ka mundësuar trajtimin mesatarisht të 75 familjeve dhe individëve në nevojë çdo muaj gjatë vitit 2023, me burimet tona të brendshme, krahas 14 familjeve dhe individëve në nevojë që trajtohen nga sistemi kombëtar i Ndihmës Ekonomike. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e këtij programi edhe gjatë vitit 2023, është përfundimi i Projektit me programet e Delegacionit të Bashkimit Evropian “SOCIAL-E”, me një fond prej 644 mijë lek për vitin 2023, projekt, i cili ka konsistuar në rikonstrukcionin e plotë të ish shkollës fillore në fshatin Dervician dhe krijimin aty të një ekspozite dhe tregu online të produkteve vendore nga gratë dhe grupe të tjera në nevojë si dhe të rinjve të Bashkisë, duke nxitur punësimin e këtyre grupeve, zhvillimin e ekonomisë reale dhe promovimin e traditave, shërbimeve dhe produkteve të zonës tonë. Po kështu në shpenzimet e këtij programi gjatë vitit 2023, janë edhe **pagesat** për PAK, invalidët, personat tetraplegjikë, paraplegjikë dhe të verbërit dhe ata që trajtohen me ndihmë ekonomike **nga MSHMS, si funksion i deleguar**. Ato gjatë vitit 2023 janë realizuar në vlerën 33.362 mijë lek, me tendencë uljeje nga viti 2022 (4.261 mijë lek më pak), për shkak të uljes së numrit të përfituesve, pothuajse në të gjitha kategoritë e cituara më lart.

Në programin e Strehimit Social (10661).

Është program i ri për Bashkinë tone, që ka filluar të funksionojë gjatë vitit 2023, me aplikimin që është bërë në thirrjen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, për programet e strehimit social, ku qëllimi primar është evidentimi i situatës së nevojave më imediate për strehim social dhe më pas kryerja e shpenzimeve për investime për përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve dhe individëve në nevojë, kryesisht persona me aftësi të kufizuara dhe ata që trajtohen me ndihmë ekonomike. Këto investime do të realizohen nëpërmjet aplikimit në programet sociale të strehimit, në bazë të planit pesëvjeçar, social të strehimit, të miratuar nga Këshilli i Bashkisë në fund të vitit 2022. Qëllimi afatgjatë është trajtimi dhe dhënia e zgjidhjeve nëpërmjet programeve të strehimit social, gjithë kërkesave të grupeve në nevojë, duke aksesuar fillimisht projektin e përmirësimit të kushteve të banimit në komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara, ku janë edhe nevojat më të mëdha. Vlerat e investimeve në këtë Program të planifikuar për vitin 2023, ishin në vlerën 1.603 mijë lek dhe ishin pjesa e bashkëfinancimit të Bashkisë (20%) në këto projekte strehimi social, që u aplikuan gjatë vitit 2023, ku Bashkia jonë u shpall fituese në këto projekte gjatë këtij viti dhe është duke u kryer investimi për përmirësimin e kushteve të banimit në 7 familjet dhe individët që kanë aplikuar. Por vonesa në disbursimin e fondeve dhe kushtet e vështira atmosferike gjatë muajve Nëntor-Dhjetor të vitit të kaluar, nuk mund të lejonin ndërhyrje në abjentet e brendshme, në shtëpitë e banimit të përfituesve. Prandaj pjesëmarrja jonë u realizua vetëm 9%, edhe sepse fondet tona trashëgohen për vitin 2024, ku do

përfundojë edhe kjo Kontratë.

Detyrime te prapambetura

Në fund te vitit 2023, detyrimet e prapambetura në bazë të formatit “Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare”, te raportuara në 12-mujorin, (Janar-Dhjetor) 2023, që dërgojmë në MFE, janë 4.480 mijë lek, që përbëjnë 1,89%, të totalit të shpenzimeve të rishikuara nga burimet e veta, të vitit 2023 dhe janë detyrime ndaj OSHEE, sipas akt marrëveshjes, dt.25.08.2022.Shlyerja e detyrimit të prapambetur ndaj OSHEE, si diferencë, është parashikuar në buxhetin e vitit 2024 dhe në buxhetin e vitit 2025 (kohe, ne te cilen, parashikohet shlyerja e plote e ketij detyrimi).

Reziqet financiare dhe fiskale.

Buxheti i vitit 2023 ka qënë i ballancuar dhe te gjitha angazhimet dhe objektivat e ndermarra nga ana e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive te pushtetit tonë vendor (Kryetari dhe Këshilli Bashkiak), kane qënë brenda mundesive të burimeve të financimit. Të gjitha shpenzimet e realizura gjatë kësaj periudhe, në të gjitha programet buxhetore të shpenzimeve që zbaton Bashkia jonë, janë brenda limitit te miratuar të shpenzimeve të çdo programi buxhetor (të aprovuara nga Këshilli Bashkiak). Bashkia jone nuk paraqet veshtiresi financiare dhe as rezik per tu ndodhur ne kushtet e veshtiresisë financiare. Nuk kemi detyrime te prapambetura të pashlyera, të pabuxhetuara, të cilat mund te cënojnë nivelin aktual dhe të ardhshëm të shpenzimeve, me ndikim ne sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për komunitetin tonë.

Konkluzione.

Nga ana e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve dhe Drejtuesve të tyre të punohet më tepër për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ekonomik, që bën të mundur realizimin e plotë të shpenzimeve në aktivitetet, mallrat dhe shërbimet e planifikuara, ndjekjen e cilësisë dhe efektivitetit të këtyre veprimtarive, si dhe zhvillimin e analizave periodike lidhur me ecurinë e tyre, me synim arritjen e objektivave bazë të Bashkisë, por edhe të objektivave konkretë të çdo programi dhe aktiviteti buxhetor. Sugjerojmë që pas miratimit të Raportit nga Këshilli i Bashkisë, të përcaktohen detyrat për të ardhmen, në kuadër të monitorimit të realizimit të buxhetit të vitit 2024, si edhe hartimit të PBA 2025-2027 dhe fazës së parë të tij, që janë miratimi i taveveve përgatitore të shpenzimeve sipas programeve, ku deri më 20 Mars 2024, do duhen miratuar në Këshillin e Bashkisë.

(Bashkangjitur: Aneksi 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”; Aneksi 2 “Raporti i shpenzimeve të programit sipas shpenzimeve”, Aneksi 3 “Realizimi i treguesve të performancës; Aneksi 4 “realizimi i objektivave të politikës së programit”; “Raporti realizimit të investimeve me financim te brendshëm” dhe “Realizimi i detajuar i të ardhurave viti 2023”.)

K R Y E T A R I

Dhimitraq TOLI

